

POLITIKË

për privatësi dhe cookies të KB Shoqëria e parë pensionale AD Shkup

KB Shoqëria e parë pensionale AD Shkup (më tej në tekst e referuar si: Shoqëria) në pajtueshmëri me veprimtarinë që e kryen, kryen edhe përpunimin e të dhënave personale në pajtueshmëri me dispozitat e vlefshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Shoqëria kujdeset për privatësinë nëpërmjet respektimit të së drejtës së privatësisë, nëpërmjet respektimit të parimeve dhe dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe përpunimin ligjor të tyre, duke përdorur teknika dhe masa të numërta organizative.

Përpunimi i të dhënave personale

Të dhënat personale që i mbledh Kompania në rolin e Kontrolluesit, të cilat janë lëndë e përpunimit të mëtejshëm, i mbledh ekskluzivisht me qëllime të përcaktuara me ligj, dhe për çdo qëllim tjetër siguron Deklaratë të veçantë për pajtueshmëri (pëlqim) për përpunimin e të dhënave personale nga subjektet e të dhënave personale.

Vëllimi i përpunimit

Në pajtueshmëri me ligjin, Shoqëria në kuadër të veprimtarisë së saj primare, ka obligim edhe t'i informojë anëtarët e saj në lidhje me të drejtat e tyre në lidhje me sigurimin pensional si edhe për informacione të lidhura me statusin e tyre në Shoqëri, me ndryshimet në rregulloren ligjore, lëvizjen e tregjeve financiare, rendimentet e realizuara, kompensimet e arkëtuara edhe për informacione të tjera në lidhje me sistemin pensional. Gjatë përpunimit të të dhënave personale, Shoqëria përdor masa të përshtatshme teknike dhe organizative me qëllim sigurimin e mbrojtjes së përpunimit të tyre. Në atë kuptim, në Shoqëri në mënyrë aktuale zbatohen kontrole të rregullta të brendshme, auditime të jashtme, vlerësim të cënueshmërisë dhe teste penetruese me të cilat përcaktohet edhe vërtetohet niveli i konfidencialitetit, sigurisë, integritetit dhe disponueshmërisë së IS dhe të dhënave që përpunohen në kuadër të tyre. Afatet e ruajtjes për të dhënat personale që përpunohen janë të definuara në pajtueshmëri me ligjin dhe me aktet e brendshme, dhe pas skadimit të afatit të ruajtjes, të dhënat shkatërrohen në pajtueshmëri me procedurat e parashikuara të brendshme.

Shoqëria ka tendencën që të sigurojë të dhëna sa më shumë të përditësuara të jetë e mundur nga subjektet e të dhënave personale me qëllim njoftimin e tyre në kohë.

Persona të autorizuar për përpunimin e të dhënave personale

Në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, Shoqëria lëshon autorizime të veçanta për përpunimin e tyre për personat të cilët kanë kontraktuar marrëdhënie afariste me Shoqërinë. Këta persona të autorizuar, para njohjes me punën e tyre, dhe njëkohësisht nëpërmjet organizimit të trajnimeve të vazhdueshme njihen me mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale. Personat e autorizuar kanë nënshkruar me dorën e vet Deklaratë për konfidencialitet dhe mbrojtje të përpunimit të të dhënave personale. **Servise të Shoqërisë**

Portal – Llogaria ime

Gjatë përdorimit të portalit për llogari personale, Shoqëria nga personat që hyjnë i mbledh këto kategori të të dhënave personale (në formë jo të lexueshme), IP adresën, datën dhe orën e hyrjes. Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet portalit dhe shoqërisë dhe personave që hyjnë në portal (për shembull: emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi) zhvillohet nëpërmjet lidhjes së kriptuar (https). Në pajtueshmëri me ligjin, çdo anëtar dhe anëtar i pensionuar i fondeve me të cilat menaxhon Shoqëria, duhet të fitojë emër përkatës përdorimi dhe fjalëkalim për hyrje në portal.

Forma e kontaktit

Me përdorimin e formës së kontaktit, personat në Shoqërinë i dorëzojnë këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin, adresën e-mail, numrin e telefonit. Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet faqes së internetit (formës së kontaktit) të Shoqërisë dhe personave që i vendosin të dhënat në formë zhvillohet nëpërmjet lidhjes së kriptuar (https). Të dhënat që i siguron Shoqëria nëpërmjet kësaj forme, do t'i përdorë ekskluzivisht për komunikim me dorëzuesin në lidhje me mesazhin e tij.

Komunikim në internet (Web chat)

Ky servis shërben për fitimin e informacioneve të përgjithshme në lidhje me sistemin pensional, informacione për Shoqërinë, si edhe për fitimin e informacioneve për statusin e personave që janë anëtarë në disa nga fondet me të cilat menaxhon Shoqëria. Të dhënat që i siguron shoqëria nëpërmjet Chat-it, do t'i përdorë ekskluzivisht për komunikim me dorëzuesin në lidhje me mesazhin e tij.

Numri i telefonit për kontakt – 02/3243777

Ky servis shërben për fitimin e informacioneve të përgjithshme në lidhje me sistemin pensional, me informacionet për Shoqërinë, si edhe për fitimin e informacioneve për statusin e personave që janë anëtarë në disa nga fondet me të cilat menaxhon Shoqëria. Të gjitha

thirrjet të krijuara nëpërmjet kontaktit në numrin e telefonit të Shoqërisë, në pajtueshmëri me shkresën me shkrim nga MAPAS regjistrohen me qëllim kontrollin e cilësisë së shërbimit si edhe përmirësimin e informimit të anëtarësisë. Në lidhje me këtë, AMDHP ka miratuar aktvendim të veçantë me të cilin miratohet përpunim i të dhënave biometrike që e kryejnë persona të autorizuar të Shoqërisë.

Kanale të tjera përmes të cilave mblidhen të dhënat personale janë lidhja e kontratave për anëtarësim në një fond pensional të detyrueshëm dhe lidhja e kontratave për anëtarësim dhe skema pensionale profesionale në një fond pensional vullnetar, si dhe të gjitha proceset shoqëruese që lidhen me anëtarësimin në fondet e pensionale, trashëgimitë, marrëdhëniet e punës, kryerja e punës agjenturore dhe kanale të tjera sipas rregullores.

Të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave personale:

Sipas Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, ju keni të drejta për të cilat duhet t'ju informojmë. Të drejtat që janë të disponueshme varen nga qëllimi, respektivisht shkaku për përpunimin e të dhënave tuaja personale. Më shumë informacione me këtë temë mund të gjeni në faqen e internetit të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale www.azlp.mk respektivisht të bëni pyetje tek oficeri ynë për mbrojtjen e të dhënave personale ose tek organi kompetent shtetëror, respektivisht trupi rregullator i info@privacy.mk. Në vijim do t'i gjeni informacionet themelore respektivisht ato bazike në lidhje me të drejtat e lartpërmendura:

1. E drejta e qasjes

Keni të drejtë që të kërkonit nga ne kopje nga të dhënat tuaja personale. Kjo e drejtë aplikohet gjithmonë. Ekzistojnë disa përjashtime, sipas ligjit, që do të thotë se jo gjithmonë mund t'i fitoni të gjitha informacionet që i përpunojmë.

2. E drejta e korrigjimit

Keni të drejtë që të kërkonit nga ne që t'i korrigjojmë informacionet që mendoni se nuk janë të sakta. Ju gjithashtu keni të drejtë që të kërkonit nga ne t'i kompletojmë informacionet që mendoni se nuk janë të plota. Kjo e drejtë aplikohet gjithmonë.

3. E drejta e fshirjes

Keni të drejtë që të kërkonit nga ne t'i fshijmë të dhënat tuaja personale në rrethana të caktuara. Kjo e drejtë aplikohet vetëm nën kushte të caktuara në pajtueshmëri me ligjin.

4. E drejta e kufizimit të përpunimit

Keni të drejtë që të kërkonit nga ne ta kufizojmë, respektivisht ta ndërpresim përpunimin e të dhënave tuaja personale në rrethana të caktuara në pajtueshmëri me ligjin.

5. E drejta që të kundërshtoni (kërkesë që të ndërpritet plotësisht me përpunimin) përpunimin.

Keni të drejtë që të kundërshtoni ndaj përpunimit vetëm nëse përpunimi i të dhënave tuaja personale nuk paraqet pjesë të obligimeve tona ligjore ose është në interesin tonë legjitim.

6. E drejta e transmetueshmërisë së të dhënave

Kjo ka të bëjë vetëm me informacionet që ju na i jepni. Ju keni të drejtë që të kërkonit t'i transferojmë informacionet, respektivisht të dhënat personale që na i jepni në nga organizmin në tjetrin (kontrollor) ose t'ia u japim ju. E drejta aplikohet vetëm në përpunime të dhëna personale të themeluara me pajtueshmërinë tuaj, ose në procesin për lidhjen e kontratës ku ju personalisht jeni njëra palë respektivisht nëse përpunimi është i automatizuar ose nëse i përpunojmë informacionet tuaja për qëllime të zbatimit të obligimeve ligjore nga domeni i së drejtës penale dhe procedurës.

- Nga ju nuk do të kërkohet që të paguani ndonjë lloj takse, respektivisht kompensim për mënjanimin e të drejtave të lartpërmendura përveç nëse ajo në varësi të kërkesës suaj është e lidhur veçanërisht numër i madh operacionesh ose aktivitete të lidhura me implikime fiskale për çka do të jeni të informuar paraprakisht. Në lidhje me atë që është cekur më parë janë përcaktuara përjashtime në pajtueshmëri me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Për realizimin e të drejtave tuaja, në pajtueshmëri me dispozitën mesatare, respektivisht veprimi sipas kërkesës suaj, në pajtueshmëri me ligjin kishte afat për një muaj për përgjigje.

7. E drejta që të ankoheni (E drejta e kundërshtimit)

Ne punojmë me standarde të larta kur bëhet fjalë për përpunimin e informacioneve tuaja personale, megjithatë nëse keni çfarëdo lloj pyetje ose problemi na kontaktoni në contact@kbprvo.com.mk dhe ne do t'ju përgjigjemi.

Nëse megjithatë në çdo rast mbeteni të pakënaqur, mund të parashtroni ankesë për mënyrën në të cilën i përpunojmë të dhënat tuaja personale tek Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale në info@privacy.mk

Formularët relevantë që kanë të bëjnë me të drejtat e subjekteve të të dhënave personale janë të disponueshme në faqen e internetit të Shoqërisë në pjesën "Dokumente për anëtarët".

Profilim

Shoqëria nuk bën profilizim të subjekteve të të dhënave personale për çfarëdo lloj qëllimi.

Marketing i drejtpërdrejtë

Shoqëria mund të kryejë marketing të drejtpërdrejtë vetëm pas pajtueshmërisë paraprake nga personat subjekte të të dhënave personale.

Biskota (Cookies)

Cookies (“biskota”) janë skedarë të vegjël që përdoren për mbledhjen e informacioneve nëpërmjet të cilave mundësohet njohja e kompjuterit tuaj respektivisht pajisjes ku gjatë vizitës së ardhshme në faqen tonë të internetit me çka mundësohet qasje më e shpejtë. Gjithashtu në raste të caktuara regjistrojmë informacione në formë të “Cookies” në kompjuterin tuaj, ose pajisje tjetër që e përdorni me qëllim që ta aftësojmë vizitën në faqen e internetit sipas nevojave dhe cilësimeve tuaja.

Të gjitha informacionet që ruhen (regjistrohen) në kuadër të „Cookies“ do të shfrytëzohen vetëm për nevojat e faqes së internetit dhe ajo në mënyrë në të cilën Privatësia juaj nuk do të cenohet ose komprometohet.

Me qasjen respektivisht përdorimin e kësaj faqeje interneti, konsiderohet se jeni njohur d.m.th jeni pajtuar, respektivisht i pranoni dispozitat e caktuara në Politikën për privatësi të Shoqërisë.

Pse përdorim biskota (Cookies)?

Në faqen tonë të internetit përdorim biskota (Cookies) për këto arsye:

1. Për funksionimin teknik të faqes së internetit;
2. Për mbledhjen e të dhënave përmbledhëse dhe anonime statistikore;
3. Që t’i ruajmë preferencat Tuaja për gjuhën
4. Që të mbajmë mend/të kujtohem, nëse pajtoheni (ose jo) me përdorimin tuaj të Cookies në këtë faqe interneti
5. Njëkohësisht mbledhim të dhëna për çka përdorim shërbim nga palë e tretë Google Analytics për të mbledhur informacionin standard të aksesit dhe detajet e sjelljes së vizitorëve, por në një mënyrë që askush të moj jetë i identifikuar, as Google nuk i lejohej ta zbulojë identitetet e atyre që vizituan faqen tonë të internetit.
6. Mblidhen Cookies për çka përdoret shërbim nga palë e tretë Facebook, për funksionimin e modulit shtesë për Live chat.

Kur do ta vizitoni faqen tonë të internetit, mund të mbledhim edhe disa informacione të tjera në lidhje me të dhënat e kërkimit tuaj, si për shembull: IP adresën tuaj, cilën përmbajtje të faqes së internetit të Shoqërisë e keni vizituar, kur e keni vizituar dhe se nga cila faqe interneti jeni ridrejtuar.

Kur e vizitoni faqen tonë të internetit përdorim shërbim të palës së tretë Google Analytics për të mbledhur informacionin standard të aksesit dhe detajet e sjelljes së vizitorëve, por në një mënyrë që askush të moj jetë i identifikuar, as Google nuk i lejohet ta zbulojë identitetin e atyre që vizituan faqen tonë të internetit.

Çfarë lloj Cookies përdorim?

Përdorim Cookies të përhershme që e ruajnë kërkimin/seksionin kur përdoruesi do ta fikë kërkuesin, me qëllim të mbahet gjendja e përdoruesit.

Gjatë kërkimit të parë në faqen tonë të internetit keni mundësinë që të njiheni me llojin e cookies dhe me mundësinë që të përzgjidhni se çfarë lloj Cookies do të lejoni që të vendosen në pajisjen tuaj. Për atë qëllim shfaqet dritare e veçantë (pop-up) me informacione për cookies.

Përzgjedhjen e Cookies gjithashtu mund ta bëni nëpërmjet opsionit – Cookie settings, në ekranin fillestar të faqes së internetit të Shoqërisë.

Informacione si t'i pamundësoni Cookies për të gjitha faqet e internetit ?

Menuja („Help“) „ndihmë“ në shiritin me vegla në Kërkuesin e internetit të kompjuterit tuaj i jep këto informacione për përdoruesit:

- Si ta parandaloni pranimin e Cookies të reja në kërkues;
- Si ta cilësoni kërkuesin që t'ju njoftojë kur do të pranoni Cookies të re;
- Si t'i shkyç plotësisht Cookies.

Ekzistojnë shumë informacione online për Cookies siç është <http://www.allaboutcookies.org> (në gjuhën angleze), në rast se dëshironi të lexoni më shumë.

Për shembull, nëse përdorin versionin Explorer 11.0, duhet të bëni procedurat e mëposhtme

- Përzgjidhni „Settings“, dhe më pas „Internet Options“;
- Klikoni në skedën „Privacy“;
- Me ndihmë të menusë zbritëse t'i përzgjidhni opsionet që i preferoni.

Mbikëqyrje video

Shoqëria nuk kryhen mbikëqyrje video në asnjë lloj forme.

Dhënia e të dhënave personale subjekteve të treta - përpunues

Kompania siguron të dhëna personale nga subjektet e të dhënave personale vetëm për subjektet me të cilat ka një marrëdhënie biznesi të kontraktuar dhe ka lidhur një Kontratë për sigurinë e sistemit të informacionit dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale, ku në mënyrë të detajuar janë rregulluar mënyrat dhe kushtet për përpunimin e tyre.

Transferimi i të dhënave personale në shtete të tjera

Në pajtueshmëri me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, shtete të tjera janë vende ku është siguruar nivel i përshtatshëm për mbrojtjen e të dhënave personale d.m.th ato janë shtete anëtare të BE ose vende anëtare të Hapësirës Ekonomike Evropiane. Shoqëria mund të kryejë transferim të të dhënave personale për shkak të plotësimit të Kontratës në interes të subjektit të të dhënave personale ndërmjet Kontrollorit dhe personit të tretë dhe ajo në shtete anëtare të BE ose vende anëtarë të Hapësirës Ekonomike Evropiane.

Serverët e faqes së internetit të KB Shoqëria e Parë Pensionale ndodhen në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kështu që të dhënat personale nuk transferohen.

Veprimi në rast të incidentit/zbulimit të paautorizuar/në rast të humbjes së të dhënave personale

Në rast të një incidenti sigurie, zbulim ose humbje e të dhënave personale, Shoqëria nëse disponon me të dhëna për kontakt i njofton subjektet e prekura të të dhënave personale për incidentin e lindur, dhe nëse bëhet fjalë për incident të përmasave më të mëdha, Shoqëria për atë njofton nëpërmjet një njoftimi publik ose nëpërmjet një publikimi përkatës në faqen e saj të internetit jo më vonë 72 orë nga njohja me incidentin e lindur.

Mbrojtja e të dhënave personale gjatë përdorimit të Facebook

Në faqen tonë të internetit është integruar komponentë në Facebook. Facebook është rrjet social – vend për takime sociale në Internet që përdoruesve u mundëson që të komunikojnë njëri me tjetrin në hapësirë virtuale. Rrjeti social mund të shërbejë si platformë për shkëmbimin e mendimeve dhe përvojave ose për fitimin e informacioneve personale ose afariste. Facebook u mundëson përdoruesve që të krijojnë profile private, të vendosin fotografi dhe të lidhen nëpërmjet kërkesave për miqësi.

Facebook, Inc., 1 Hacker Way, Menlo Park, California 94025, Shtetet e Bashkuara të

Amerikës (SHBA) është kontrollor i të dhënave të subjekteve nga SHBA dhe Kanadasë. Nëse subjekti jeton jashtë nga SHBA dhe Kanadasë, kontrollor është. Facebook Ireland Ltd., 4 Grand Canal Square, Grand Canal Harbour, Dublin 2, Irlandë.

Gjithmonë kur do ta vizitoni faqen tonë të internetit, në të cilën është integruar komponentë e Facebook (Facebook plug-in), kërkuesi i internetit të sistemit tuaj informativ nxitet automatikisht që të dërgojë pamje të komponentës përkatëse të Facebook. Shqyrtim i të gjitha Facebook plug-in mund të sigurohet në <https://developers.facebook.com/docs/plugins/>. Gjatë kohës së këtij procesi teknik Facebook është i informuar për atë se cilën faqe interneti e keni vizituar.

Facebook gjithmonë pranon informacione për vizitën në faqen tonë të internetit, kur jeni të loguar në Facebook gjatë kohës së vizitës në faqen tonë të internetit. Nëse nuk i dëshironi këto informacione që të transferohen në Facebook, dilni nga profili juaj i përdorimit në Facebook para se ta vizitoni faqen tonë të internetit.

Udhëzimi për mbrojtjen e të dhënave e publikuar nga Facebook është e disponueshme në <https://facebook.com/about/privacy/>. Ajo përmban informacione për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave personale nga ana e Facebook. Përveç kësaj, është e shpjeguar se çfarë procedura ofron Facebook për mbrojtjen e privatësisë suaj. Në mënyrë plotësuese, janë të disponueshme opsione të ndryshme të cilësimeve që të pamundësohet transferimi i të dhënave në Facebook.

Mbrojtja e të dhënave personale gjatë përdorimit të Instagram

Në faqen tonë të internetit është integruar komponentë në Instagram. Instagram është shërbim që mund të përshkruhet si platformë audiovizuale, që përdorueseve u mundëson shpërndarjen e fotografive dhe video incizimeve, si edhe shpërndarje të të dhënave të tilla në rrjetet e tjera sociale.

Facebook Ireland Ltd., 4 Grand Canal Square, Grand Canal Harbour, Dublin 2 Irlandë është kontrollori i të dhënave personale që përpunohen nëpërmjet Instagram.

Gjithmonë kur do ta vizitoni faqen tonë të internetit, në të cilën është integruar komponenta Instagram (butoni Insta), kërkuesi i internetit në sistemit të informacionit të përdoruesit, automatikisht kërkon që të shkarkojë pamje nga komponenta përkatëse Instagram. Gjatë kësaj procedure teknike, Instagram e di se cilën faqe të internetit e keni vizituar.

Nëse njëkohësisht jeni loguar në Instagram, Instagram i detekton të gjitha vizitat në faqen tonë të internetit nga ana juaj dhe të gjithë kohën e kaluar në faqen tonë të internetit. Ato të dhëna mblidhen nëpërmjet komponentit Instagram dhe lidhen me Profilin tuaj të Instagram. Nëse klikoni në butonin Instagram që është e integruar në faqen tonë të internetit, Instagram i lidh këto të dhëna me profilin tuaj personal të përdoruesit në Instagram dhe i ruan të dhënat personale.

Instagram pranon informacione nëpërmjet komponentit Instagram se e keni vizituar faqen tonë të internetit nën kushtin që njëkohësisht të jeni të loguar në Instagram gjatë kohës së

vizitës në faqen tonë të internetit. Ajo ndodh pavarësisht nga ajo nëse keni klikuar në butonin Instagram apo jo. Nëse nuk dëshironi që këto informacione të transferohen në Instagram dilni nga profili i Instagramit para se ta vizitoni faqen tonë të internetit.

Informacione plotësuese dhe dispozita të vlefshme për mbrojtjen e të dhënave personale të Instagram mund të gjenden në këtë link:

<https://help.instagram.com/155833707900388> и

<https://www.instagram.com/about/legal/privacy/>.

Mbrojtja e të dhënave personale gjatë përdorimit të YouTube

Në faqen tonë të internetit është integruar komponent i YouTube, YouTube është video portal interneti që mundëson publikimin pa pagesë të video klipëve, si edhe shikimin pa pagesë të tyre, shikimin dhe komentimin e tyre. YouTube ju mundëson publikimin çdo lloj video incizimi, ku mund të keni qasje të plotë në filma, Emisionet TV, video muzikore, prezantime dhe video të bëra nga përdoruesit nëpërmjet portalit të internetit

Google Ireland Limited, Gordon House, Barrow Street, Dublin, D04 E5W5, Irlandë është kontrollori i të dhënave personale që përpunohen nëpërmjet YouTube.

Me çdo hapje të një nga faqet e veçanta të kësaj faqe interneti, me të cilën menaxhon kontrollori dhe në të cilën është integruar komponent i YouTube (video në YouTube), automatikisht kërkohet kërkuesi i internetit të sistemit të informacionit të përdoruesit ta shkarkojë komponentin përkatës të YouTube. Informacione shtesë për YouTube mund të gjeni në <https://www.youtube.com/about/>.

YouTube dhe Google do të fitojnë informacione nëpërmjet komponentit të YouTube që subjekti i të dhënave personale e ka vizituar faqen tonë të internetit, nëse subjekti i të dhënave personale gjatë kohës së hapjes së faqes sonë të internetit është i loguar në YouTube; kjo ndodh pa dallim nëse personi ka klikuar në video në YouTube apo jo. Nëse subjekti i të dhënave personale nuk dëshiron që ky informacion të transferohet tek YouTube dhe Google në atë rast duhet të dalë nga profili i tij personal në YouTube para se ta hapë faqen tonë të internetit.

Dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale në YouTube, të disponueshme në <https://www.google.com/intl/en/policies/privacy/>, sigurojnë informacione për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave personale nga YouTube dhe Google.

Mbrojtja e të dhënave personale gjatë përdorimit të Google Analytics

Në faqen tonë të internetit është integruar komponent i Google Analytics. Google Analytics është shërbim për analizë të internetit – mbledhje dhe analizë e të dhënave për sjelljen e përdoruesëve në faqet e internetit. Mes të tjerave, mbledhen informacione për faqen e

internetit nga e cila e ka prejardhjen përdoruesi (i ashtuquajtur Referrer), si edhe sa shpesh dhe sa gjatë zgjat vizita në faqen e internetit. Analiza e internetit kryesisht përdoret për optimizimin (përmirësimin) e faqes së internetit.

Kompania që e siguron komponentin Google Analytics e Google Ireland Limited, Gordon House, Barrow Street, Dublin, D04 E5W5, Irlandë.

Google Analytics vendos cookies në sistemin informativ të përdoruesit. Definimi për biskotat është shpjeguar më lart. Me vendosjen e biskotës, Google mund ta analizojë përdorimin e faqes sonë të internetit. Biskota përdoret për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave personale, siç janë koha e qasjes, vendi nga ku kryhet qasja dhe shpeshtësia e vizitave në faqen tonë të internetit nga ana e përdoruesit. Me çdo vizitë në faqen tonë të internetit, të dhënat e tilla personale, duke përfshirë edhe IP adresën që e përdor përdoruesi për qasjen në Internet, do të transferohen në Google në SHBA dhe të ruajtura nga Google në SHBA. Google mund t'i transferojë këto të dhëna personale palëve të treta.

Me cilësimin e përshtatshëm të kërkuesit të internetit mund të parandaloni vendosjen e biskotave nëpërmjet faqes sonë të internetit, por edhe të ndaloni në mënyrë të përhershme vendosjen e biskotave. Cilësimi i tillë i faqes së internetit gjithashtu do të mund të pengonte që Google Analytics të vendosë biskota në sistemin tuaj informativ. Përveç kësaj, biskotat që tashmë i përdor Google Analytics mund të fshihen në çdo kohë nëpërmjet kërkuesit të internetit ose programeve të tjera softuerike.

Njëkohësisht, mund të shkarkoni dhe të instaloni shtesë të kërkuesit të internetit në <https://tools.google.com/dlpage/gaoptout>. Kjo shtesë e kërkuesit të internetit i tregon Google Analytics nëpërmjet JavaScript të mos transferohen çfarëdo lloj informacionesh për vizitat tuaja në faqet e internetit. Instalimi i shtesave të kërkuesit konsiderohet si ankesë ndaj Google. Nëse sistemi juaj informativ më vonë fshihet, formatohet apo instalohet përsëri, duhet t'i instaloni përsëri shtesat e faqes së internetit që përsëri ta pamundësojë Google Analytics. Nëse shtesa e kërkuesit të internetit është e çinstaluar ose e pamundësuar, është e mundur që të instalohet ose të aktivizohet përsëri.

Informacione plotësuese dhe dispozita të vlefshme për mbrojtjen e të dhënave nga Google mund të shkarkohen në:

<https://policies.google.com/privacy?hl=en> dhe

<https://marketingplatform.google.com/about/analytics/terms/us/>.

Google Analytics është i shpjeguar në mënyrë plotësuese në këtë link:

<https://marketingplatform.google.com/about/analytics/>.

Të dhëna për kontakt:

Kontrollor KB Shoqëria e Parë Pensionale AD Shkup

<https://www.kbprvo.com.mk/>

contact@kbprvo.mk

02/ 3243777

Oficer për mbrojtjen e të dhënave personale në Shoqëri

Emri dhe mbiemri: Andrijana Zairovska

E-mail: andrijana.zairovska@kbprvo.com.mk

Telefon celular për kontakt: 02 5513 585

Mbikëqyrës i sigurimit pensional me financim kapital - MAPAS

<http://www.mapas.mk> contact@mapas.mk 02/3224229

Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale

AMDHP <https://dzlp.mk> info@privacy.mk 02/3230635

Kjo politikë hyn në fuqi nga dita e miratimit të saj. Kjo politikë, si edhe versionet e reja dhe/ose versionet e ndryshuara të saj do të jenë të publikuara në mënyrë publike në faqen e internetit të Shoqërisë.

KRYETAR I BORDIT DREJTUES

Vesna Stojanovska